



Pranuar / Dorezuar Primljeno/Prodato Received/Delivered	24.08.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojc # Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTICK	5807	2023	1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.948/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demianëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.948/2023 të datës 07.02.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë: [redacted], kundër Vendimeve të Administratës Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 24.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Shfuqizohet Vendimi i datës 10.07.2023 dhe Vendimi i datës 15.06.2023 i Drejtorit të Departamentit Tatimor Rajonal-Ferizaj në kuadër të Administratës Tatimore të Kosovës, ndërsa lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë.
- II. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, që t'i ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi sikurse në pikën I të dispozitivit, brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i cili sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Administrata Tatimore e Kosovës, me datë 12.07.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil e cila është regjistruar me shenjën A.nr.948/2023 dhe numër protokolli:5128/2023, kundër Vendimi të datës 15.06.2023 të Drejtorit të Departamentit Rajonal të Administratës Tatimore të Kosovës në Ferizaj, ndërsa me datën 04.08.2023 ka bërë plotësimin e ankesës duke kundërshtar

Vendimin e datës 10.07.2023 Drejtorit të Departamentit Rajonal të Administratës Tatimore të Kosovës në Ferizaj.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë me rastin e shqiptimit të masave disiplinore, ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike, ka shkelur dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik me kërkesën që Këshilli të aprovojë ankesën e ankueses si të bazuar, ndërsa të anulojë vendimin e Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë të datës 15.06.2023 dhe Vendimin e datës 10.07.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 14.07.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Administrata Tatimore e Kosovës. Ndërsa me datën 20.07.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për shqyrtimin e kësaj ankese administroi këto prova: Plotësim ankesa me numër protokollit 948/2023 e datës 04.08.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshill; Vërejtja e lëshuar Administrata e Tatimore e Kosovës e datës 10.07.2023; Formula Ndryshim Kontrolli; Dëshmia e Pushimit vjetor për [redacted] E-mail i dërguar nga [redacted] drejtuar [redacted] i datës 03.07.2023; E-mail i dërguar nga A.J drejtuar [redacted] i datës 14.07.2023; E-mail i dërguar nga [redacted] drejtuar [redacted] e datës 16.06.2023; Vërejtja e lëshuar Administrata e Tatimore e Kosovës e datës 15.06.2023; Raport i kontrollit i datës 29.06.2023; Ankesën me numër te protokollit 5128/2023 të datës 12.07.2023 të parashtruar nga ankuesi; Pagesa e faturave e datës 26.03.2023; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 14.07.2023; Përgjigja në ankesë e datës 20.07.2023; Vendimi me numër protokollit 776 i datës 28.12.2022; Akt emërimi për [redacted] me numër prot.1482 i datës 28.12.2022; Vendimi për transferim me numër 2760 i datës 27.12.2022; Formulari i përshkrimit të detyrave të punës; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë 2022 i datës 30.01.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë 2021 i datës 04.02.2022; E-mail i dërguar nga [redacted] drejtuar V.S e datës 17.07.2023; Email i dërguar nga [redacted] drejtuar [redacted] dhe S.R e datës 28.04.2023; E-mail i dërguar nga [redacted] drejtuar [redacted], etj e datës 05.05.2023; Udhëzues për kohëzgjatjen e kontrolleve e datës 16.03.2022; Email i dërguar nga [redacted] drejtuar [redacted] etj e datës 08.05.2023; Lista e kontrolleve e datës 05.05.2023; Kontrollat në Sigtas e datës 05.05.2023; E-mail i dërguar nga [redacted] drejtuar [redacted] e datës 12.04.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [redacted] duhet të kthehet në *ri-shqyrtim* dhe *rivendosje* tek organi i njëjtë, *sepse*:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesi [redacted] është i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës, ndërsa Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së përmes Vendimit me numër të protokollit 776 të datës 28.12.2022 e ka emëruar ankuesin në pozitën "Zëvendës i Udhëheqësi të Divizionit për Aktivitete Operative" në Departamentin Tatimor Rajonal Ferizaj duke e ngarkuar të njëjtin që t'i kryej detyrat dhe përgjegjësit dhe atë duke filluar nga data 28.12.2022 e deri në momentin e plotësimit të pozitës.

Drejtori i Departamentit Tatimor Rajonal-Ferizaj në cilësinë e Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejtë përmes Vendimit të datës 15.06.2023, ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje" bazuar në nenin 47 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik për shkak të shkeljes së rëndë disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publik sikurse përcaktohet "mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda", ndërsa Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejtë, po ashtu përmes Vendimit të datës 10.07.2023 ankuesit i ka

shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje" bazuar në nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik duke mos specifikuar se çfarë shkelje disiplinore ka bërë ankuesi, ndërsa arsyetimi lidhur me shkeljen e supozuar mbetet i njëjtë.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e nenit 47 paragrafi 1 ku përcaktohet se: "1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil." ndërlidhur me nenin 13 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik ku thuhet se: "Kompetent për shqiptimin e masave disiplinore sipas kësaj Rregullore janë: 1.1. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt dhe 1.2. Komisioni Disiplinor. 2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt shqipton masën disiplinore të përcaktuar në nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit për shkeljet e përcaktuara me nenin 46 paragrafi 4 të Ligjit. 3. Komisioni disiplinor shqipton masat disiplinore të përcaktuara në nenin 47 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 deri 1.4 të Ligjit për shkeljet e përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 të Ligjit" dhe ka ardhur në përfundimin se Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë përmes Vendimit të datës 15.06.2023 ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje" lidhur me shkeljen e kualifikuara sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ndërsa për shkelje të tilla të kualifikuara sipas nenit 46 paragrafi 3 është kompetentë vetëm Komisionin Disiplinor të konstatoi dhe eventualisht të shqiptojë masë disiplinore, ngase kemi të bëjmë me shkelje të natyrës së rëndë.

Ndërsa, sa i përket Vendimit të Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të datës 10.07.2023 përmes të cilit akt ankuesit i është shqiptuar masa e dytë disiplinore "Vërejtje" mirëpo në arsyetimin e të njëjtës shqiptuesi i masës nuk ka arritur të konstatoj saktë se për cilën shkelje disiplinore ankuesit i shqiptohet masa disiplinore, ngase me nenin 13 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik përcaktohet se: "Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt shqipton masën disiplinore të përcaktuar në nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit për shkeljet e përcaktuara me nenin 46 paragrafi 4 të Ligjit", nga rrjedh se fillimisht ka qenë e nevojshme të konstatohet apo të kualifikohet shkelja nëse e njëjta hynë në kuadër të nenit 46 paragrafi 4 të Ligjit Nr.04/L-114 për Zyrtarët Publik, e më pastaj sipas kompetencës ligjore nga Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë t'i shqiptohet masa disiplinore sikurse dispozitat e kësaj rregulloreje, ngas për t'i hapur rrugë kompetencës lidhur me shqiptimin e masës disiplinore, parakusht ligjor është që fillimisht shkelja e supozuar të kualifikohet.

Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin se arsyetimi i dhënë nuk ka arritur të qartësojë shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën janë marrë vendimet, kualifikimin e shkeljes, shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, bazën ligjore të vendimit dhe arsyeën pse është e zbatueshme në rastin konkret, prandaj në mbështetje të nenit 48 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-131 të Ligjit për procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se "Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij", prandaj në mbështetje të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-131 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: " 1.4. është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material", Kolegji i Këshillit konstatoi se Vendimi i datës 10.07.2023 dhe ai i datës 15.06.2023 të nxjerrë nga Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë i ankuesit janë akte administrative të paligjshme dhe si i tilla janë shfuqizuar sikurse në dispozitivin e këtij vendimi.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të vendimeve të Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejtë, gjegjësisht Vendimit të datës 15.06.2023 dhe Vendimit të datës 10.07.2023 ku ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore "Vërejtje" ka konstatuar se i njëjti përmes dy Vendimeve i ka shqiptuar ankuesit masën e njëjtë disiplinore dhe njëherit përmes Vendimit të datës 10.07.2023 nuk është bërë shfuqizimi i vendimit paraprak duke lënë të nënkuptohet që për të njëjtin rast i janë shqiptuar dy masa disiplinore, veprime këto të cila janë në kundërshtim me nenin 50 paragrafi 5 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: "5. Për çdo shkelje, jepet vetëm një masë disiplinore.", nga rrjedh se Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë i ka shqiptuar ankuesit dy masa disiplinore për të njëjtën shkelje të supozuar.

Prandaj, nga se u tha si më lartë, pas analizimit të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë si dhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ekzistojnë arsyet të mjaftueshme që lënda e ankuesit të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë me qëllim që i njëjti gjatë rishqyrtimit të lëndës të bëjë kualifikimin e shkeljes sipas udhëzimeve me dispozitat e nenit 7 paragrafët 4, 5 dhe 6 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik ku përcaktohet se: "4. Në rast se informacioni i marrë rezulton të ketë elemente si shkelje disiplinore, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë bën kualifikimin e shkeljeve sipas nenit 46 të Ligjit. 5. Në rast se shkelja klasifikohet sipas nenit 46 paragrafi 4 nën paragrafët 4.1 deri 4.4 të Ligjit, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë fillon procedurën disiplinore sipas nenit 48 paragrafit 2 të Ligjit. 6. Në rast kur shkelja kualifikohet sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafët 3.1 deri 3.11 të Ligjit, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë kërkon nga komisioni disiplinor të fillojë procedurën disiplinore sipas nenit 48 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1 të Ligjit", nga rrjedh se Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë i ankuesit me rastin e rishqyrtimit të kësaj lënde, fillimisht duhet të konstatoi apo kualifikojë shkeljen, dhe më pastaj nëse e njëjta hynë në kuadër të shkeljeve të rënda i njëjti duhet që pa vonesë të paraqesë kërkesën për inicim të procedurës disiplinore pranë Komisionit Disiplinor, ndërsa nëse shkeljen e kualifikon se hynë në kuadër të shkeljeve të lehta atëherë në cilësi të Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejtë mund t'i shqiptojë masën e caktuar disiplinore sipas kompetencës, mirëpo në secilin rast përveç respektimit të dispozitave të ligjit material, rregullores në fjalë duhet respektuar edhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Prandaj, nga se u tha si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, lënda e ankuesit është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje për shkak të shkeljeve procedurale dhe interpretim të gabuar të së drejtës materiale, ndërsa Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë kthimin e lëndës në ri-shqyrtim dhe rivendosje nga ana e Këshillit nuk mund dhe nuk duhet ta cilësoi si konstatim i kryerjes së shkeljes disiplinore nga ana e ankuesit, ngase Kolegji i Këshillit për shkak të shkeljeve të lartcekura procedurale nuk ka mundur të verifikoj dhe konstatoi faktin nëse ankuesi ka kryer apo jo shkelje disiplinore, prandaj lëndë është kthyer në rivendosje tek organi apo zyrtari që ka nxjerrë fillimisht aktet e goditura përmes ankesës së datës 12.07.2023 dhe plotësimit të saj me datë 04.08.2023.

Andaj, bazuar në këto rrethana, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, gjegjësisht nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur i cili pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.948/2023

Flakron Gashi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore e Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Administrata Tatimore e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

